



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 17 nëntor 2014  
Nr. ref.: VTK728/14

## VENDIM PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA

në

**Rastin Nr. KI115/14**

Parashtrues

**Azem Ademi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së një aktvendimi të paidentifikuar të një autoriteti publik të paidentifikuar**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### Parashtruesi i kërkесës

- Kërkesa është dorëzuar nga z. Azem Ademi, nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkësës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kérkesës nuk e identifikon një aktvendim të ndonjë organi publik i cili kontestohet, edhe pse ai i referohet Aktvendimit për papranueshmëri, në Rastin nr. KI62/10, parashtrues i kérkesës *Azem Ademi kundër Ministrisë së Drejtësisë*, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 18 marsit 2011.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi i kérkesës nuk pretendon shkelje të dispozitave kushtetuese në dëm të tij në çfarëdo mënyre qoftë. Sidoqoftë, parashtruesi i kérkesës përmend "*Arsyetim në lidhje me lëndën, rasti nr. KI-62*", pa nxjerrë asnjë përfundim.

## **Baza juridike**

4. Me sa duket kérkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji). Në të vërtetë, parashtruesi i kérkesës nuk përmend asnjë dispozitë ligjore sipas së cilës ai e parashtron kérkesën dhe ai madje as nuk e ka plotësuar formularin e kérkesës.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 7 korrik 2014, parashtruesi e dorëzoi kérkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
6. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI115/14, caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI115/14, caktoi Kolegin shqyrtaues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Ramahajrizi.
7. Më 13 gusht 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kérkesës.
8. Më 17 shtator 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit rapportues, Kolegi shqyrtaues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kérkesës.

## **Përbledhja e fakteve**

9. Më 12 korrik 2010, parashtruesi e dorëzoi kérkesën në Gjykatë, duke u ankuar, *inter alia*, se Ministria e Drejtësisë nuk i ka dhënë atij të drejtat e caktuara të cilat ai pretendon se i takojnë si qytetar i një vendi që ishte pjesë e Bashkimit Evropian.
10. Më 18 mars 2011, Gjykata nxori Aktvendim për papranueshmëri në Rastin nr. KI62/10 duke e refuzuar kérkesën e parashtruesit si qartazi të pabazuar.
11. Më 7 korrik 2014, parashtruesi i kérkesës e dorëzoi një faqe të letrës duke deklaruar, *inter alia*, "*Arsyetimi në lidhje me lëndën, rasti nr. KI-62*".

## Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi i kërkesës, *inter alia*, deklaron se “*Gjykata e Posaqme do t' i gjykonte akuzat, nga "Raporti për Kosovën" në rast se vërtetohen. Rasti, unë, Azem Ademi, aktualisht banor i Prishtinës, shtetas i Republika e Kosovës, nuk duhet të akuzohet ngajashëm me rastin Radovan Karagjiq, shtetas jugosllav, ish jugosllavja, i akuzuar për Krime Lufte, aktualisht në procesin gjyqësor, Tribunali i Hagës*”.
13. Parashtruesi i kërkesës nuk thirret në shkelje të ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

## Pranueshmëria e kërkesës

14. Para së gjithash, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës [Juridiksiioni dhe Palët e Autorizuara], i cili parasheh:

*"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

16. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

*"Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme, ose që nuk përfaqësojnë një rast ose një kontest".*

17. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar një faqe të letrës pa e kontestuar ndonjë vendim të ndonjë autoriteti publik dhe pa ndonjë pretendim lidhur me shkeljen e dispozitave kushtetuese në dëm të tij. Për më tepër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar një “kërkesë” të paqartë dhe të pakuptueshme.
18. Gjykata vëren se procedurat në Gjykatën Kushtetuese janë kundërshtuese për nga natyra dhe prandaj nuk është çështje e Gjykatës ta ndërtojë rastin në emër të parashtruesit të kërkesës. Përkundrazi, kjo duhet të bëhet nga vetë parashtruesi i kërkesës, i cili duhet t'i drejtohet Gjykatës, në përputhje me të gjitha kriteret e pranueshmërisë së kërkesës.
19. Nga sa u tha më lart, Gjykata konsideron se letra e lartpërmendur prej një faqjeje nuk e kalon pragun minimal që të konsiderohet kërkesë. (Shih rastin nr. KI62/14, Parashtrues i kërkesës Rexhep Haziri, Vendim për heqje të kërkesës nga lista, i 4 gushtit 2014, gjithashtu mutatis mutandis shih rastin Starodub kundër Ukrainës, Nr. 5483/02, Vendim i GJEDNJ-së, i 7 qershorit 2005).

20. Gjykata konkludon se nuk ka rast ose kontest të pazgjidhur lidhur me çështjen e lartpërmendur dhe në pajtim me rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, "kërkesa" duhet të hiqet nga lista.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 32 (4) a) të Rregullores së punës, më 17 shtator 2014, njëzëri


### VENDOS

- I. TA HEQË kërkesën nga lista;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari rapportues**

  
Almiro Rodrigues

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

  
Prof. dr. Enver Hasani